

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Katedra Civilo-Juridike, Fakulteti Juridik
<b>Titulli i lëndës:</b>	E Drejta e Kompanive (Përfshirë të Drejtën e Konkurrencës)
<b>Niveli:</b>	Master - Kontrata dhe e Drejta Komerçiale
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	I
<b>Numri i orëve në javë:</b>	3+1
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5 ECTS
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësit e lëndës:</b>	Prof.Asoc. Dr. Valbon Mulaj
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:valbon.mulaj@uni-pr.edu">valbon.mulaj@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Në kuadër të plan-programit akademik në studimet Master (LL.M.) në Kontrata dhe e Drejta Komerçiale për lëndët, kurset mësimore të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, për lëndë Obligative në semestrin e dytë (semestrin veror), është caktuar: E Drejta e Kompanive (Përfshirë të Drejtën e Konkurrencës), me fond javor të orëve mësimore (tri orë ligjërata dhe një orë ushtrime) me gjithsej pesë kredi. E Drejta e Kompanive (Përfshirë të Drejtën e Konkurrencës), si disiplinë e përgjithshme shkencore hyrëse, teorike dhe praktike, ka për synim ofrimin e njohurive për kompanitë (përfshirë të drejtën e konkurrencës), sipas legjislacionit nacional dhe evropian.</p> <p>Rregullimi ligjor dhe funksionimi i konkurrencës është një prej parakushteve kryesore për funksionimin e mirëfilltë të kompanive në tregun nacional dhe në atë evropian. Përmes zbatimit të konkurrencës, kompanitë bëjnë garë midis tyre dhe si rezultat i konkurrencës, ofrojnë produkte më cilësore dhe shërbime me efikase. Kjo konkurrencë shkon në interes të konsumatorëve, si në tregun vendor edhe në atë evropian. Lënda ka për qëllim që studentët, pas përfundimit, të jenë në gjendje të zbatojnë në praktikë të drejtën e kompanive (përfshirë të drejtën e konkurrencës).</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i lëndës është të aftësojë studentët të studimeve Master në aspektin teorik dhe praktik në fushën e të drejtës së kompanive (përfshirë të drejtën e konkurrencës). Studentët do të marrin njohuri për mënyrën e funksionimit të kompanive në tregun vendor dhe evropian, si dhe për rolin dhe për rëndësinë e funksionimit të konkurrencës në tregun vendor dhe evropian. Studentët do të zotërojnë njohuri për ndikimin pozitiv të konkurrencës për aspekte të përmirësimit të shërbimeve dhe të</p>

	rritjes së cilësisë të kompanive në treg. Po ashtu, studentët do të kuptojnë mbrojtjen nga konkurrenca jolojale.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Lënda: E Drejta e Kompanive (Përfshirë të Drejtën e Konkurrencës) do të ligjërohet duke u ofruar studentëve njohuri të reja dhe të përshtatshme rreth të drejtës dhe nevojave që ka tregu për rregullimin në pikëpamje juridike. Në përfundim, studentët duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kenë njohuri të avancuara për të drejtën e kompanive (përfshirë të drejtën e konkurrencës);</li> <li>- të kenë njohuri mbi llojet e kompanive, të cilat njihen sipas legjislacionit të Kosovës;</li> <li>- të jenë të aftë të themelojnë dhe të përfaqësojnë kompanitë në tregun vendor dhe evropian;</li> <li>- të jenë të aftë të draftojnë dokumente të themelimit të kompanisë dhe të finalizojnë regjistrimin në organet publike në Republikën e Kosovës;</li> <li>- të jenë të aftë të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjet e aplikueshme për kompanitë në Kosovë dhe të aplikueshme sipas direktivave të Bashkimit Evropian;</li> <li>- të hulumtojnë tregun vendor dhe evropian lidhur me shkeljet e konkurrencës nga kompanitë;</li> <li>- të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjet për mbrojtjen e konkurrencës në tregun vendor dhe në atë evropian;</li> <li>- të mbrojnë konkurrencën nga aktet jolojale.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	1/15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/7	7
Kontaktet me mësimdhënësin/konsulti met	1	1/15	15
Ushtrime në terren	1	1/4	4
Kollokfiume, seminare	1	1/7	7
Detyra të shtëpisë	1	1/5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/8	8
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1/7	7
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	1/1	5

Projektet, prezantimet, etj.	7	1/7	7
<b>Totali</b>	<b>5 ECTS</b>	<b>Total</b>	<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Prezantimi i temës mësimore në ligjërata bëhet përmes Power Point-it, diskutimeve interaktive, ushtrimeve. Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza, hulumtime dhe ushtrime individuale dhe grupore. Rast studimi apo detyrë lidhur me temën e ligjëruar.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Për vlerësimin e studentëve, mësimdhënësi do të ketë në konsideratë këto kritere.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi i vazhdueshëm:</u></p> <p>Pikët në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi individual.....5 pikë;</li> <li>- Prezantimi dhe puna grupore.... ..5 pikë;</li> <li>- Punimi seminarik.....10 pikë;</li> <li>- Testi i parë ..... 40 pikë;</li> <li>- Testi i dytë ..... 40 pikë.</li> </ul> <p>Studentët që arrijnë rezultat pozitiv përmes vlerësimit të vazhdueshëm, lirohen nga provimi.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi në provimin final:</u></p> <p>Studentët që nuk arrijnë sukses përmes vlerësimit të vazhdueshëm, hyjnë në provimin final. Provimi final ka gjithsej 80 pikë, kurse 20 pikët e cekura më lartë arrihen nga: Prezantimi individual - 5 pikë; Prezantimi dhe puna grupore - 5 pikë; Punimi seminarik - 10 pikë. Të gjitha këto pikë numërohen dhe transferohen në provimin final.</p>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Eva Micheler: <i>Company Law a real entity theory</i>. First Edition published in 2021.</li> <li>- Michael Quilter: <i>Company Law Perspectives</i>. Fourth Edition Lawbook co. 2020.</li> <li>- Barry J. Rodger &amp; Angus MacCulloch “ <i>Competition Law and Policy in the EU and UK</i>”. Sixth edition published 2022.</li> </ul>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Enver Hasani &amp; Ivan Čukalović, “<i>Komentar - Kushtetuta e Republikës së Kosovës</i>”. Botimi I, Prishtinë 2013.</li> </ul>		

- Eriona Katro & Vaeld Zhezha “E drejta e konkurrencës në Bashkimin Europian dhe në Shqipëri (Competition Law in the European Union and Albania)”. Tirana, 2016.
- D. Ashton, *Competition Damages Actions in the EU*, Law and Practice second edition. Economics Contribution from Frank Maier - Riguid and Ulrich Schwalbe. Elgar Competition Law and Practice. 2018.
- Edited by Fabiana Di Porto & Rupprecht Podszun: “*Abusive Practices in Competition Law*”. 2018.
- Edited by David Bosco & Michal S. Gal: “*Challenges to Assumptions in Competition Law*”. Edditors and Contributors Severally 2021. ISBN-978-1- 83910-906-5 (cased), ISBN-978-1-83910-907-2 (eBook).
- Edited by Weijer VerLoren van Themaat Berend Reuder:” *Eglar Commentaries – European Competition Law – A Case Commentary*”. The Editors and Contributors Severelly 2018.
- John Duns & Arlen Duke & Brendan Sweeney: “*Comparative Competition Law*”. The Editors and Contributors Severally 2015.
- Mehdi J. Hetemi: ”*Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut*”, Prishtinë, 2005.
- Jonida Lamaj, “*E drejta e konkurrencës në kuadrin e lirisë kushtetuese ekonomike (Competition law in the framework of constitutional economic freedom)*”. Doctoral dissertation, Tirana 2018.
- Jonida Kazani, “*Aspekte ligjore të së drejtës së konkurrencës dhe konkurrenca në sistemin elektroenergjetik Shqiptar (Legal aspects of competition law and competition in the Albanian power system)*”. Doctoral dissertation, Tirana 2015.
- Ann Ridley & Chris Shepherd: “*Key facts key cases Company Law*”. First Edition published in 2015.
- Edited by Beate Sjafjell & Benjamin J. Richardson: “*Company Law and Sustainability Legal Barriers and Opportunities*”. Cambridge University Press 2015.
- Janet Dine & Marios Koutsias: “*Company Law*”. Palgrave Macmillan Law Masters – Eighth Edition. This edition first published 2014. ISBN-978-0-230-36207-9.
- Valbon Mulaj, “Protection of Competition from Abuse with Dominant Positions and Anticompetitive Agreements in the Kosovo Market”, *Studia Iuridica Lublinensia* 31, no. 2 (2022): 207-227.
- Valbon Mulaj, “*Improvement of the Kosovo Market through Implementation of the Competition Legal Framework*”, Journal: The Lawyer Quarterly, 2020, Vol. 10 (3).

- Irena Pekarskiene & Jurgita Bruneckiene., “*The Relationship between Cartels and Economic Fluctuations*”, Journal: Inzinerine Ekonomika-Engineering Economics, 2015.
- Jaspers J. D., “*Managing Cartels: how Cartel Participants Create Stability in the Absence of law*”, Journal: European Journal on Criminal Policy and Research (2017).
- Justyna Maliszewska-Nienartowicz., “*The abuse of the dominant position within the internal market of the European Community: From theoretical assumptions to practice*”, January 2007.
- Christian Lorenz., “*Screening markets for cartel detection: collusive markers in the CFD cartel-audit*”, Journal: European Journal of Law and Economics, 2008.
- Ovidiu Maican., “*Abuse of a Dominant Position*”, Journal: Current Issues in Business Law, 2018.
- EU Competition Law Rules Applicable to Antitrust Enforcement. Volume I: General Rules. Situation as at 1st of July 2013.
- Andreas Cahn & David C. Donald, “*Comparative Company Law*”, Cambridge University Press (September 6, 2010), ISBN-10: 0521143799, ISBN-13: 978-0521143790.
- Adriaan Doresteijn, et.al., “*European Corporate Law*”, Wolters Kluwer Law & Business; second edition (June 30, 2009), ISBN-10: 9041124845, ISBN-13: 978-9041124845.
- Allison Jones and Brenda Sufrin, “*EU Competition Law*”, Oxford University Press, USA; 4 edition (December 9, 2010), ISBN-10: 0199572739, ISBN-13: 978-0199572731.
- Raby, Paul, “*Business Law in Practice*”, ICSA Publishing Ltd 2005.
- Bishop, Bernard, “*European Union Law for International Business*”, Cambridge University Press 2009.
- Mark – Oliver Mackenrodt & Beatriz Conde Gallego & Stefan Enchelmaier Editors: “*Abuse of Dominant Position: New Interpretation, New Enforcement Mechanisms?*”. Max Planck Institute for Intellectual Property Competition and Tax Law. 2008 Springer-Verlag Berlin Heidelberg, ISBN- 978-3-540-69958-3, e-ISBN- 978-3-540-69965-1.
- Materiale të përgatitura ose përmbledhura nga profesori i lëndës, dhe të dorëzuara më kohë, që lejon hapësirë të mjaftueshme për studim përpara ligjëratës përkatëse.
- Raste të përgatitura nga Profesori.

*Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës:*  
*Ligji për Shoqëritë Tregtare.*  
*Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës.*  
*Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit.*

	<p><i>Ligji për Investimet e Huaja.</i>  <i>Ligji për Tregti me Jashtë.</i>  <i>Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.</i>  <i>Ligji për Markat Tregtare.</i>  <i>Ligji për Arbitrazhin.</i>  <i>Ligji për Ndërmjetësimin.</i>  <i>Ligji për Falimentimin.</i>  <i>Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.</i></p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<p><b>Prezantimi i lëndës, i literaturës, si dhe i rregullave.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vështrime të përgjithshme mbi lëndën: E Drejta e Kompanive (Përfshirë të Drejtën e Konkurrencës)</li> </ul>
<i>Java e dytë:</i>	<p><b>Tema: Rregullimi ligjor i kompanive</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi ligjor i kompanive në Kosovë;</li> <li>• Rregullimi ligjor i kompanive në Evropë.</li> </ul>
<i>Java e tretë:</i>	<p><b>Tema: Kompania dhe fushëveprimi i saj</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përkufizimi, roli dhe rëndësia e kompanive në treg;</li> <li>• Natyra dhe karakteristikat e kompanisë;</li> <li>• Procedura për regjistrimin e kompanive – Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë;</li> <li>• Llojet e kompanive;</li> <li>• Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë;</li> <li>• Krahasimi me llojet e tjera të shoqërive tregtare.</li> </ul>
<i>Java e katërt:</i>	<p><b>Tema: Organizimi dhe funksionimi i kompanive në tregun vendor dhe evropian</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi dhe funksionimi i kompanive në tregun vendor;</li> <li>• Organizimi dhe funksionimi i kompanive në tregun evropian.</li> </ul>
<i>Java e pestë:</i>	<p><b>Tema: Bashkimi, ndarja, likuidimi dhe falimentimi i kompanive</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një analizë për tjetërsimin e aksioneve si model i ndryshimit të pronësisë së kompanive (korporatave);</li> <li>• Bashkimi dhe ndarja e kompanive;</li> <li>• Kontratë për bashkimin e kompanive;</li> <li>• Kontrata për shitjen e kompanisë;</li> <li>• Fillimi i procedurës së likuidimit;</li> <li>• Përgjegjësitë ndaj kreditorëve;</li> <li>• Roli i likuidatorit dhe Gjykatës.</li> </ul>
<i>Java e gjashtë:</i>	<p><b>Tema: Rregullimi ligjor i konkurrencës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi ligjor i konkurrencës në Kosovë;</li> <li>• Rregullimi ligjor i konkurrencës në Evropë;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi dhe funksionimi i kompanive në tregun vendor dhe evropian;</li> <li>• Domosdoshmëria e respektimit të konkurrencës nga kompanitë në tregun vendor dhe në atë evropian;</li> <li>• Çka do të ndodhte me tregun në rast të mosrregullimit ligjor dhe mosfunksionimit të konkurrencës në tregun vendor dhe atë Evropian.</li> </ul>
<b>Java e shtatë:</b>	<b>Testi I</b>
<b>Java e tetë:</b>	<p><b>Tema: Roli, përgjegjësitë dhe kompetencat e institucionit kompetent për mbrojtjen e konkurrencës në Kosovë dhe në Evropë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i Kushtetutës dhe i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës;</li> <li>• Zbatimi i Statutit, i rregulloreve dhe i akteve të tjera;</li> <li>• Ndërtimi i mekanizmave për të lehtësuar marrjen e informacioneve me kohë për çrregullimin e konkurrencës në treg;</li> <li>• Krijimi i marrëveshjeve me institucione të tjera vendore për mbikëqytjen më të lehtë të tregut dhe respektimin e konkurrencës nga ana e kompanive;</li> <li>• Krijimi i marrëveshjes me institucionet kompetente të mbrojtjes së konkurrencës të shteteve të Evropës;</li> <li>• Zbatimi më i lehtë dhe më i mirë, si rezultat i aplikimit të praktikave të institucioneve kompetente për mbrojtjen e konkurrencës të shteteve të Evropës;</li> <li>• Bashkëpunimi i institucionit kompetent me organet gjyqësore dhe me organe të tjera për mbrojtjen e konkurrencës.</li> </ul>
<b>Java e nëntë:</b>	<p><b>Tema: Pozitat dominuese dhe mbrojtja e konkurrencës nga abuzimi me pozitat dominuese në mes kompanive në treg</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pozitat dominuese;</li> <li>• Mbrojtja e konkurrencës nga abuzimi me pozitat dominuese midis kompanive në treg, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në Kosovë (LMKK);</li> <li>• Mbrojtja e konkurrencës nga abuzimi me pozitat dominuese midis kompanive në treg, sipas Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE);</li> <li>• Shqiptimi i masave ndëshkuese lidhur me abuzimin me pozitat dominuese midis kompanive në treg, sipas LMKK-së;</li> <li>• Shqiptimi i masave ndëshkuese lidhur me abuzimin me pozitat dominuese midis kompanive në treg, sipas TFBE-së;</li> <li>• Përmbarimi i masave ndëshkuese, parashkrimi;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raste praktike lidhur me abuzimin me pozitat dominuese në tregun vendor dhe evropian.</li> </ul>
<b>Java e dhjetë:</b>	<p><b>Tema: Mbrojtja e konkurrencës nga marrëveshjet kundërkonkurrese midis kompanive në treg</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbrojtja e konkurrencës nga marrëveshjet kundërkonkurrese midis kompanive në treg, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në Kosovë (LMKK);</li> <li>• Mbrojtja e konkurrencës nga marrëveshjet kundërkonkurrese midis kompanive në treg, sipas Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE);</li> <li>• Shqiptimi i masave ndëshkuese ndaj marrëveshjeve kundërkonkurrese në treg, sipas LMKK-së;</li> <li>• Shqiptimi i masave ndëshkuese ndaj marrëveshjeve kundërkonkurrese në treg, sipas TFBE-së;</li> <li>• Përmbartimi i masave ndëshkuese, parashkrimi;</li> <li>• Raste praktike lidhur me marrëveshjet kundërkonkurrese në tregun vendor dhe evropian.</li> </ul>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<p><b>Tema: Përqendrimi i kompanive</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përqendrimet e ndaluara;</li> <li>• Detyrimi për njoftimin e realizimit të përqendrimit;</li> <li>• Njoftimi për qëllimin e realizimit të përqendrimit;</li> <li>• Përmbajtja e njoftimit për realizimin përqendrimit;</li> <li>• Procedura e vlerësimit për lejimin e përqendrimit;</li> <li>• Vërtetimi për lejimin e përqendrimit dhe vendimi për vlerësimin e përqendrimit;</li> <li>• Shfuqizimi dhe ndryshimi i vendimit për përqendrimin;</li> <li>• Masat pas realizimit të paligjshëm të përqendrimit.</li> </ul>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<p><b>Tema: Zhvillimi i procedurës nga institucioni kompetent për mbrojtjen e konkurrencës në Kosovë dhe në Evropë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i procedurës nga Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në Kosovë;</li> <li>• Zhvillimi i procedurës sipas TFBE-së;</li> <li>• Zhvillimi i procedurës nga disa institucione për mbrojtjen e konkurrencës të disa shteteve të Evropës;</li> <li>• Aspekte krahasuese.</li> </ul>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<p><b>Tema: Përmirësimi i tregut në Kosovë dhe Evropë përmes zbatimit të konkurrencës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i tregut në Kosovë përmes zbatimit të konkurrencës nga kompanitë në treg;</li> <li>• Përmirësimi i tregut në Evropë, përmes zbatimit të konkurrencës nga kompanitë në treg;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i produkteve dhe i shërbimeve nga kompanitë, si rezultat i zbatimit të konkurrencës në tregun vendor dhe evropian;</li> <li>• Ndikimi pozitiv të konsumatorët përmes zbatimit të mirëfilltë të konkurrencës nga kompanitë në treg;</li> <li>• Trajtimi dhe analizimi i rasteve praktike lidhur me çrregullimin e konkurrencës në tregun nacional dhe atë evropian.</li> </ul>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<b>Testi II</b>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Tema: Përmbledhje e lëndës, si dhe publikimi i pikëve të arritura për secilin student/e</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<p>Studenti/ja duhet të jetë i/e ndërgjegj-shëm/shme dhe të respektojë institucionin, statutin dhe aktet e tjera ligjore të UP-së; duhet të respektojë orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve; të marrë pjesë dhe të jetë aktiv në orën mësimore; student-i/ja është i/e obliguar ta posedojë me vete ID kartelën në teste dhe provim final; gjatë hartimit të punimeve seminarike, student-i/ja duhet t'u përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student/e. Prandaj, studentët duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale. Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform akteve ligjore të UP-së.</p>	